

VENDIM
Nr 158, Datë 13.02.2008

**PËR IMPORT-EKSPORTIN E BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes , të pikës 3 të nenit 82 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “ Kodi doganor në Republikën e Shqipërisë”, dhe neneve 3 dhe 7 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, me propozim të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI :

- 1.Burimet radioaktive që do t’i nënshtrohen proceduarave të import-eksportit, si dhe pajisjet dhe sistemet ,ku ato inkorporohen, janë përcaktuar në listën e miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.
- 2.Veprimet në pikat doganore për import - eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues kryehen vetëm pasi personat, fizikë apo juridikë, të kenë paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a)Licencë për veprimtari import-eksporti me burime të rrezatimit jonizues, lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi
 - b)Leje për import - eksportin e burimeve të rrezatimit jonizuese, përkatësisht:
 - për burimet e kategorive 1 e 2, lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.
 - për burimet e kategorive 3,4 e 5 dhe gjeneratorëve me rrezatim x, të lëshuar nga zyra për mbrojtjen nga rrezatimet.
 - c) certifikatën e cilësisë së gjeneratorëve me rreze x, lëshuar brenda dy viteve të fundit, nga çasti i importimit.
3. Vendimi nr.56, datë 24.02.2000, i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali BERISHA